

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË PROJEKTIN “MALET DREJT TREGUT”, NË
AGJENCINË E ZHVILLIMIT TË ZONAVE MALORE (MADA)**

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Projektin “Malet drejt tregut”, në Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i projektit deri me datë 30.04.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.115, datë 11.09.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 514/8, datë 11.09.2015, dërguar z.Edmond Panariti, Ministër i Buqësisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i kryer konstatohet se në kategorinë 1 “Punime civile”, kanë mbetur pa paguar nga fondet e akorduara nga kredia e IFAD në shumën 9,274,540 lekë, nga kontributi i komunave në shumën 4,188,764 lekë dhe nga fondet e GOA në shumën 1,240,957 lekë, përkatësisht për firmat kontraktore, në shumën 1,074,063 lekë, në shumën 1,770,733 lekë, në shumën 6,769,467 lekë, në shumën 4,592,370 lekë, dhe&..... në shumën 497,628 lekë. Meqenëse MADA përfundon aktivitetin e saj financiar në datë 30.06.2015, paraprakisht nga kryetarët e Njësive Administrative dhe Vendore përfituese duhet të merren në dorëzim punimet, me qëllim që financa e projektit të bëjë likuidimet e detyrimeve që rezultojnë të papaguara për 5 kontraktuesit.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA dhe Njësia e Drejtimit të Programit, të marrin masa për të kryer procedurat të rregullta për marrjen në dorëzim nga kryetarët e Njësive Administrative dhe Vendore respektive të veprave të përfunduara dhe të bëhet konform procedurave ligjore likuidimi detyrimeve të papaguara përkatësisht për kontraktorin, në shumën 1,074,063 lekë, në shumën 1,770,733 lekë, në shumën 6,769,467 lekë, në shumën 4,592,370 lekë, dhe&..... në shumën 497,628 lekë.

Menjëherë

2. Konstatohet se për disa kategori të projektit janë bërë tejkallime në financimin e fondeve përkatësisht:- Në kategorinë 4 “Trainime dhe seminare”, janë financuar nga kredia në shumën 68,825 SDR, me një tejkallim në shumën 4,897 SDR, dhe nga fondet e grandit janë financuar në shumën 130,261 SDR, me një tejkallim në shumën 30,261 SDR, në krahasim me fondet e parashikuara në marrëveshjen e financimit nga IFAD. Megjithëse janë rialokuar fondet e kredisë, nga MADA nuk janë kryer procedurat për të bërë për shumat e tejkaluara për të bërë përsëri rialokime të fondeve në përputhje me nevojat reale të projektit.

- Konstatohet se për nënkategoria e V.a, ka tejkallim në shumën 107,897 SDR, dhe për nënkategorinë V.b, janë tejkalluar në shumën 1,583,316 SDR, në krahasim me fondet e parashikuara pas rialokimit të marrëveshjes së financimit.

Kjo ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e projektit, që ka lejuar të kryhen pagesa duke tejkalluar fondet e parashikuara në marrëveshjen e financimit të kredisë nga IFAD, për kategorinë 4 dhe për nënkategorinë V.a dhe V.b.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA dhe Njësia e Drejtimit të Projektit, të marrin masa në të ardhmen për projektet me financime të huaja, të zbatojnë me përpikmëri financimet sipas kategorive ose komponentëve të projektit në përputhje me fondet e parashikuara në marrëveshjet e huave me donatorët.

Në vazhdimësi

3. Nga auditimi i kryer u konstatua se nga financa e MADA-as është paguar në shumën 576 euro, datë 26.02.2010, për shpenzime udhëtimi jashtë vendit, për pjesmarrje në seminarin për politikat Rajonale, në Bolonjë të Italisë, për biletat e avionit për dy persona, pagesa është bërë nga financa pa autorizimin e Drejtorit ekzekutiv i cili miraton emrat e personave që do marrin pjesë në seminar si dhe kohën e qëndrimit dhe qëllimin përse do shkojnë në këtë udhëtim. Ky veprim bindesh me MPFA, kapitulli 2, pika 2.5.3.6 “Pagesat për udhëtime për punonjësit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 119-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA dhe Njësia e Drejtimit të Projektit, të marrin masa në të ardhmen që të kryejnë pagesat me bankë për shpenzime udhëtimi jashtë vendit për punonjësit staf të projekteve me financime të huaja, që veprimet e pagesave të bëhen bazuar në urdhrat e drejtorëve ekzekutiv në përputhje me Manuali i Procedurave Financiare dhe Administrative, kapitulli 2, pika 2.5.3.6 “Pagesat për udhëtime për punonjësit”.

Menjëherë dhe vazhdimësi

4. Nga auditimi i kryer u konstatua se në vitin 2014, janë lidhur kontrata pune individuale nga drejtori ekzekutiv i MADA-as për 6 persona, për të cilën nuk janë kryer procedurat për të marrë miratimin (no objection) për çdo person që rekrutohet nga MADA me kontratë individuale pune. Në dosjen e personelit për këta 6 persona të cilët kanë lidhur kontrata pune me afate të shkurtra nga MADA, mungon no objection nga IFAD. Për pasojë IFAD nuk ka lëvruar fondin prej 20% të pagesës nga kontributi i saj, të parashikuar në marrëveshjen e huas, vlerë e cila është financuar me fondet e buxhetit të GOA. (Trajtuar më hollësisht në faqen 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA dhe Njësia e Drejtimit të Projektit, të marrin masa në të ardhmen për projektet me financime të huaja, që për çdo kontratë pune individuale që do të lidhen me punonjësit të ketë dhe no-objection (miratimin) nga donatori, me qëllim që të zbatohen me përpikmëri kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit të kredive për financimin e fondeve sipas kontributit të çdo donatori.

Menjëherë dhe vazhdimësi

5. Nga auditimi i kryer u konstatua se MADA, ka bërë rialokimin e fondeve të projektit bazuar vetën në një email të dërguar nga IFAD, duke bërë ndryshimet përkatësisht, në kategorinë 1, janë pakësuar në shumën 335,172 SDR dhe kjo shumë është shtuar në kategorinë IV, në shumën 7,586 SDR, dhe në nënkategorinë V.a, në shumën 120,689 SDR, dhe në nënkategorinë V.b, në shumën 206,897 SDR. Rialokimi i dytë i fondeve është bërë pa marrë miratimin nga Ministria e Financave, si Huamarrëse e kredisë, dhe pa miratimin e IFAD, veprim ky në kundërshtim me marrëveshjen e financimit të kredisë me IFAD, dhe me nenin 2.3.1 “Procedurat e Buxhetit” të Manuali i Procedurave Financiare dhe Administrative ku thuhet se “..Ndryshimet në kategori, natyrën e aktiviteteve dhe ndonjë rishpërndarje midis kategorive dhe natyrës së aktiviteteve, duhet ti nënshtrohet miratimit nga Donatori si dhe nga Qeveria Shqiptare..”. Drejtuesit e projektit kanë vazhduar të bëjnë financime duke lejuar tejkalimin e fondeve të kredisë të parashikuara në marrëveshjet dhe pas rialokimit të parë të bërë me VKM.

Gjithashtu konstatohet se ndryshimet e fondeve të bëra nga vetë drejtuesit e MADA-as, (pa marrë miratimin nga donatorët), janë bërë duke pakësuar fondet nga punimet civile dhe i janë shtuar në kategoritë për trajnime dhe seminare të ndryshme, kur në fakt duhet që të ndodhte e kundërta, me qëllim që shtohen punimet civile të cilat japin impakt në shtresat e popullsisë, dhe jo në kategori ndihmëse siç janë trajnimet dhe seminare të cilat jo se nuk kanë vlerë por nuk kanë të njëjtin impakt si kategoria e punimeve civile. Kjo gjë ka ardhur dhe nga fakti se nuk është marrë miratimi nga ministria e linjës dhe nga Ministria e Financave, të cilët menaxhojnë përdorimin me efektivitet të fondeve të kredive dhe huave që merr shteti shqiptar. (Trajtuar më hollësisht në faqen 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA dhe Njësia e Drejtimit të Projektit, të marrin masa në të ardhmen për projektet me financime të huaja, me qëllim që rialokimi fondeve brenda kategorive të projekteve të bëhen me miratim nga Ministria e Financës dhe nga donatorët, bazuar në argumentin e nevojës për këto ndryshime të paraqitur nga njësitet zbatuese të projekteve, në përputhje me marrëveshjet e financimit të kredive dhe me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative.

Menjëherë dhe vazhdimësi

6. Nga auditimi procedurave të tenderave të kryera me objekt “Për blerje e gomash”, “Blerje makinash”, “Blerje kancelarie”, “Blerje naftë”, dhe “Për blerje materiale pastrimi”, u konstatua se nuk janë bërë propozimet për financime drejtuar drejtorit ekzekutiv, si edhe mungon një raport i shkurtër në lidhje me përfundimin e kontratës, veprime në kundërshtim me pikën 2.5.3.2, të Manuali i Procedurave Financiare dhe Administrative, ku citohet se “Blerja e automjeteve mallrave dhe pajisjeve të zyrës dhe informatikës duhet të kenë të bashkangjitur propozimin financiar dhe pas miratimit një kopje i dërgohet juristit për të vazhduar më tej procedurën juridike”. Po kështu mungon dhe një raport i shkurtër në lidhje me përfundimin e lidhjes së kontratës.

- Janë kryer disa procedura tenderash me objekt: “Blerje Makinash”, “Blerje Kancelarie”, “Materiale Pastrimi”, ku konstatohet se nuk janë bërë procesverbalet për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, veprime në kundërshtim me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative pika 2.5.3.8 “Pagesa për kancelari”, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I, pika 1, ku citohet se “Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standard dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dhe me pikën 42 dhe 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, si dhe me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2.

-U konstatua se në procedurën e tenderit për “Blerje të makinave” mungon fatura tatimore që duhet të ishte bashkangjitur dokumentacionit të tenderit, veprime në kundërshtim me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative pika 2.5.3.2, ku citohet se “Blerja e automjeteve, mallrave dhe pajisjeve të zyrës dhe informatikës duhet të kenë të bashkangjitur edhe fatura të rregullta tatimore me numër, datë, firmë dhe vulë nga shitësi dhe blerësi”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I, pika 1, ku citohet se “Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standard dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dhe me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6, “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat në të ardhmen që të kryejë procedurat e tenderave duke respektuar kriteret e përcaktuara në Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative dhe të plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm të gjitha pagesat në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Menjëherë dhe vazhdimësi

7. Është kryer procedura për tenderin “Blerje makine” dhe nga ana e KVO-os nuk janë ndjekur procedurat ligjore për këtë blerje, për arsye se oferta e shpallur si fituese për firmën e vetme të ofruar në këtë tender, ka tejkaluar në vlerë fondin limit. Në këto kushte KVO-ja duhet të kishte ndërprerë procedurën dhe të fillonte nga e para duke rillogaritur dhe një herë fondin limit, ose të kryente procedurën po me këtë vlerë të fondit limit, veprime në kundërshtim me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative pikën 2.2 “Prokurimet”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA të marrin masat në të ardhmen që KVO-ja të kryejë e procedurat e prokurimit duke ndjekur bazën ligjore për të mos lejuar tejkalimin e fondit limit, si dhe të kryejë të gjitha procedurat e tenderave duke respektuar kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative.

Menjëherë dhe vazhdimësi

8. Konstatohet se në procedurën e kryer për tenderin “Për blerje naftë”, ka pasur mospërputhje në dokumentacion, për arsye se urdhri i prokurimit është bërë një vit mbas kërkesës për propozim, ndërkohë që kërkesa për propozim duhej të kishte dalë para krijimit të urdhrit të prokurimit, veprime në kundërshtim me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative pika 2.5.3.2, ku citohet se “Blerja e automjeteve mallrave dhe pajisjeve të zyrës dhe informatikës” duhet të kenë bashkangjitur në fillim propozimin financiar i cili i drejtohet drejtorit ekzekutiv dhe pas miratimit një kopje nga ana e juristit të përfundojë procedura juridike.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat në të ardhmen që të kryejë procedurat e tenderave duke respektuar afatet dhe kriteret të përcaktuara në Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative, duke bashkalidhur dokumentacionin në çdo procedurë prokurimi.

Menjëherë dhe vazhdimësi

9. Në procedurën e kryer për tenderin “Blerje gomash” u konstatua se, janë dhënë ofertat nga tre firma ku dy prej tyre përkatësisht dhe, janë paraqitur me çmime të cilat tejkalojnë fondin limit të përcaktuar nga MADA. Ndërsa firma e tretë ka bërë kërkesë për shtyrje afati një muaj, kërkesë kjo e pranuar nga drejtoresha e asaj periudhe zj. Mbas shtyrjes së këtij afati KVO rishqyrtoi për herë të dytë ofertat dhe kualifikoi si fituese firmën, me ofertën financiare me vlerë më të ulët se dy operatorët e tjerë, veprim në kundërshtim me Manualin e parashikuar të procedurave të prokurimeve.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masa në të ardhmen që në procedurat e tenderave KVO-ja të respektojë kriteret e përcaktuara në Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative duke mos lejuar shtyrje afati të dorëzimit të ofertave nga firmat të cilat ftohen të marrin pjesë në tendera.

Menjëherë dhe vazhdimësi

10. Në procedurat e tenderit për blerje me vlera të vogla për materiale pastrimi dhe për blerje kancelarie, konstatohet se në të dy rastet është hartuar kërkesa për materiale dhe nuk është firmosur nga personi që ka bërë kërkesën gjithashtu nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të materialeve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I, pika 1, ku citohet se “Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standard dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2, me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative pika 2.5.3.2 ku citohet se “Në rastin e blerjeve të mallrave pajisjeve të zyrës duhet të jetë bashkangjitur dokumentacioneve edhe procesverbali i marrjes në dorëzim hartuar nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të drejtorit ekzekutiv”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat në të ardhmen që të kryejë procedurat e tenderave bazuar në dokumentacionin e plotë shoqërues deri në marrjen në dorëzim të mallit duke mbajtur një proceverbale gjatë dorëzimit të mallit, për të verifikuar nëse malli i përmbush të gjitha specifikimet e kërkuara, me qëllim kryerjen e procedurës në përputhje me kriteret e përcaktuara në Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative.

Menjëherë dhe vazhdimësi

11. Në procedurën e kryer për blerje me vlerë të vogël për larje makinash dhe parkim makinash u konstatua se, bashkëlidhur kësaj procedure nuk gjendet fatura tatimore, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I, pika 1, ku citohet se “Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standard dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2, me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative pika 2.5.3.2, ku citohet se “Në rastin e blerjeve të mallrave pajisjeve të zyrës duhet të jetë bashkangjitur dokumentacioneve edhe procesverbali i marrjes në dorëzim hartuar nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të drejtorit ekzekutiv”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA të marri masa në të ardhmen që likuidimet me bankë të faturave për blerje mallrash të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e plotë, si faturë tatimore etj., në përputhje me Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2, dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011.

Vazhdimisht

12. Autoriteti Kontraktor, në të gjitha procedurat e prokurimit që ka zhvilluar në përcaktimin e vlerës limit të kontratave nuk ka shoqëruar dhe argumentuar me dokumentacion justifikues llogaritjen e vlerës së kontratës.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat që në përcaktimin e vlerës së kontratës të argumentojë përcaktimin e vlerës limit të shoqëruar kjo me dokumentacion referuar çmimeve të publikuara, kontratave të mëparshme, etj., ky dokumentacion të bëhet pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit.

Vazhdimisht

13. Nga verifikimi i kryer konstatohet se nga MADA, janë dërguar rregullisht në MBUMK për çdo vit ushtrimor bilancet kontabël për projektin, por nga ana e kësaj ministrie nuk ka shkresa në lidhje me miratimin e të dhënave financiare për këtë projekt.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA dhe Njësia e Drejtimit të Programit në bashkëpunim me MBUMK të marrin masat në të ardhmen për bilancet kontabël për projektet me financime të huaja të miratohen nga ministria e linjës, për çdo vit ushtrimor në përputhje me legjislacionin kontabël.

Në vazhdimësi

14. Në analizën e ecurisë së financimeve që nga fillimi i projektit deri në 30 prill 2015, konstatohet se, disbursimet në vitet e para ka qenë me ritme të ulëta, megjithëse janë nënshkruar marrëveshjet e financimit që në vitin 2009, dhe ecuria e disbursimeve për fondet e grandit nga IFAD ka qenë me ritme të ulëta, kjo ka ndikuar dhe në shtyrje të afatit të disbursimeve.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 28-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA dhe Njësia e Drejtimit të Programit, të marrë masat në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojë me përpikmëri të gjitha angazhimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare në lidhje me menaxhimin sa më të drejtë të zbatimit të projektit dhe rritjen e ritmeve të disbursimeve, me qëllim për realizimin e objektivave të projektit.

Në vazhdimësi

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Nga verifikimi i kryer në dokumentimin e pagesave të kryera me bankë për shpenzimet e bëra për kategorinë “Kosto periodike”, për periudhën 2009-2015, u konstatua se, nga financa e projektit janë kryer pagesa për firmën, në datë 23.10.2009, në shumën 330,010 lekë, për blerje kancelarie për projektin, të cilat janë bërë pa autorizimin për blerje nga drejtori ekzekutiv, dhe pa kontratën e lidhur me firmën, **duke sjellë dëm ekonomik në shumën 330,010 lekë.** Kjo pagesë është bërë në kundërshtim me Manuali i Procedurave Financiare dhe Administrative, Kapitulli 2, pika 2.5.3.8, ku përcaktohet se “...Pagesa për kancelari dhe materiale pastrimi do të bëhet në bazë të dokumentave të miratuara (kontrata, çeku, fatura e shitjes etj.) dhe urdhëri që autorizon blerjen, i cili aprovohet nga Drejtori Ekzekutiv (DE), me propozim të Drejtorisë së Financës dhe Administratës (DFA). Pagesa duhet të kryhet pasi materialet të jenë bërë hyrje në magazinën e ADP nga personi i ngarkuar për këtë punë”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 119-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Drejtimit të Programit dhe MADA, të marrin masa për arkëtimin e vlerës 330,010 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga pagesat e bëra për firmën, për pagesat e bëra për blerje kancelarie për projektin, pa autorizimin e drejtorit ekzekutiv dhe pa kontratë blerje, për periudhën tetor 2009, të cilat janë bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me Manuali i Procedurave Financiare dhe Administrative, Kapitulli 2, pika 2.5.3.8.

Menjëherë

2. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave me bankë për shpenzimet e bëra për kategorinë “Kosto periodike”, u konstatua se, nga financa e projektit janë kryer pagesa për shoqërinë e transportit në shumën 70,000 lekë, me datë 17.11.2009, për shpenzime transporti në lidhje me aktivitetin e zhvilluar për “Pastorizimi dhe trashëgimia kulturore”, të cilat janë bërë

bazuar vetëm në një faturë të thjeshtë tatimore të lëshuar nga kjo shoqëri transporti. E gjithë procedura e ndjekur për likuidimin e pagesës **në shumën 70,000 lekë, përbën dëm ekonomik**, për arsye se është bërë në kundërshtim me Kreun 2, pika 2.5.3.1, Manuali i Procedurave Financiare dhe Administrative (MPFA), dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 119-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Drejtimit të Programit dhe MADA, të marrin masa për arkëtimin e vlerës 70,000 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga pagesat e bëra për shoqërinë e transportit, për pagesat e bëra për shpenzimet transporti për aktivitetin e zhvilluar për “Pastorizimi dhe trashëgimia kulturore”, të cilat janë bërë bazuar vetëm në një faturë të thjeshtë tatimore të lëshuar nga kjo shoqëri transporti, për periudhën nëntor 2009, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative, Kapitulli 2, pika 2.5.3.1.

Menjëherë

3. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave me bankë për shpenzimet e bëra për kategorinë “Kosto periodike”, u konstatua se, nga financa e projektit janë kryer pagesa për konsulentin, në datë 2.12.2009, në shumën 200,000 lekë, për asistencë teknike në promovimin e bizneseve në kuadrin e Panairit kombëtar, i zhvilluar në Tiranë në shtator 2009, nga të cilat janë të pa justifikuara me dokumentacion përkatës, konkretisht “Shpenzimet për materiale” (dosje) në shumën 30,000 lekë nuk kanë fletëhyrjen e magazinës, “Shpenzimet për komunikimin” në shumën 30,000 lekë nuk kanë dokumentacionin justifikues se çfarë përfaqësojnë kjo vlerë, dhe “Shpenzime të tjera për transport” për konsulentin në shumën 20,000 lekë nuk kanë dokumentacion shoqërues për llojin dhe mjetin e transportit dhe se sa kilometra janë sipas destinacionit. Pagesa pa dokumentacion justifikues **në shumën 80,000 lekë përbën dëm ekonomik**, është në kundërshtim me Kapitullin 1, pika 2.5.3.1, i Manualit të Procedurave Financiare dhe Administrative, dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 119-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Drejtimit të Programit dhe MADA, të marrin masa për arkëtimin e vlerës 80,000 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga pagesat e bëra për konsulentin, për pagesat e bëra për asistencë teknike në promovimin e bizneseve në kuadrin e Panairit kombëtar, i zhvilluar në Tiranë në shtator 2009, të cilat janë bërë pa dokumentacionin shoqërues si fatura, fletëhyrje, si dhe mungon dokumentacioni për destinacionin dhe llojin e mjetit që do të përdoret, për periudhën shtator 2009, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative, Kapitulli 1, pika 2.5.3.1.

Menjëherë

4. Nga verifikimi i kryer në dokumentimin e pagesave të kryera me bankë për periudhën 2009-2015, u konstatua se, nga financa e projektit janë kryer pagesa për personin fizik z....., në shumën 22,500 lekë, datë 23.12.2009, për “Shpenzime blerje dosje, printime”, të cilat janë bërë vetëm me një faturë të thjeshtë tatimore, dhe me tre oferta. Nuk ka dokumentacion tjetër që të vërtetojë qëllimin se përse janë blerë. Po kështu dhe materialet që janë përdorur nuk janë bërë hyrje në magazinë. Pagesa është bërë **në emër të personit fizik z....., pa dokumentacion justifikues, në shumën 22,500 lekë, përbën dëm ekonomik**, për arsye se është bërë në kundërshtim me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative, Kapitulli 1,

pika 2.5.3.1, dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 119-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Drejtimit të Programit dhe MADA, të marrin masa për arkëtimin e vlerës 22,500 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga pagesat e bëra për personin fizik z., për pagesat e bëra për “Shpenzime blerje dosje, printime”, në periudhën dhjetor 2009, të cilat janë bërë pa dokumentacionin shoqërues që të vërtetojë qëllimin se përse janë blerë, si dhe materialet e blera nuk janë bërë hyrje në magazinë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative, Kapitulli 1, pika 2.5.3.1.

Menjëherë

5. Nga verifikimi i kryer në dokumentimin e pagesave të kryera me bankë për periudhën 2009-2015, u konstatua se, nga financa e projektit janë kryer pagesa në shumën 84,790 lekë, datë 01.07.2010, dhe në shumën 50,000 lekë, datë 01.07.2010 (Çadra), për blerje materiale promovuese për panairin e kryer në qytetin e Shkodrës “Artizani dhe gruaja Shkodrane” në 22 maj në Shkodër, si dhe janë blerë materiale për promovimin në shumën gjithsej 84,790 lekë, për postera dhe banera, dhe nuk janë bërë hyrje në magazinë. Kjo ngarkon me përgjegjësi z..... dhe z....., si persona përgjegjës staf i MADA të angazhuar për kryerjen e aktivitetit, të cilët nuk kanë zbatuar procedurat për ti bërë hyrje materialet që janë blerë për këtë aktivitet, **në shumën 134,790 lekë, e cila përbën dëm ekonomik në të ardhurat e projektit, për arsye se pagesa është bërë në kundërshtim me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative, kapitulli 2, pika 2.5.3.1, dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.**

(Trajtuar më hollësisht në faqen 119-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Drejtimit të Programit dhe MADA, të marrin masat për arkëtimin e vlerës 134,790 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga pagesat e bëra për z..... dhe z....., si persona përgjegjës (staf i MADA-as), për aktivitetin “Shpenzime blerje dosje, printime”, në periudhën korrik 2010, për arsye se materialet e blera nuk janë bërë hyrje në magazinë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative, Kapitulli 2, pika 2.5.3.1.

Menjëherë

6. Në procedurën e kryer për “Blerje makinash” Autoriteti Kontraktor ka nënshkruar kontratën me firmën, me vlerë 12,455,000 lekë. Nga ana e KVO-së janë dërguar ftesat për ofertë për tre kompani ku vetëm një prej tyre i është përgjigjur ftesës për ofertë. Ka vazhduar procedura e vlerësimit të ofertave nga KVO, vetëm me firmën, e cila ka paraqitur vlerën më të lartë se fondi limit në shumën 15,800 lekë. Për të vazhduar procedurën më tej KVO-ja ka kërkuar no- objection nga IFAD, për shtesën prej 6,000 lekësh dhe jo për gjithë shtesën e kontratës së lidhur me fituesin në shumën prej 15,800 lekësh. Nga IFAD-i nuk është marrë no objection për shtesën mbi fondin limit në shumën prej 15,800 lekësh. Nga KVO janë shkelur procedurat e tenderit “Blerje makinash”, duke tejkaluar fondin limit për firmën e shpallur fituese me një diferencë më të lartë **prej 15,800 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik në të ardhurat e projektit.** *(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

MADA të marri masat për arkëtimin e vlerës 15,800 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga KVO-ja, i përbërë nga zj. kryetare dhe anëtarët z., z., z. dhe ish drejtorët ekzekutiv të projektit z. dhe zj., për shkelje në procedurën e tenderit për “Blerje Makinash”, në kundërshtim me Manualin e Procedurave të Prokurimit, pika III “Procedurat e prokurimit” dhe pika IV “Përshkrimi i procedurave të prokurimit”.

Menjëherë

7. Është zhvilluar procedura me vlerë të vogël për realizimin e dy workshopeve për trajnimin e punonjësve, ku komisioni ka shpallur firmën si fituese me çmimin më të ulët. Bashkëlidhur në dokumentacionin e tenderit u konstatua se gjendet fatura tatimore me nr. 20470310, datë 26.03.2015, e lëshuar një vit më pas se urdhri i pagesës i datës 20.04.2014, për pasojë pagesa e bërë nga financa për firmën, **me vlerën 267,360 lekë është dëm ekonomik**, për arsye se është bërë pa dokumentacion shoqërues, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I, pika 1, ku citohet se “Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standard dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2, dhe me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative” pika 2.5.3.2.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA të marri masat për arkëtimin e vlerës 276,360 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga zj., përgjegjëse e departamentit të financës, e cila ka likuiduar firmën pa dokumentacion shoqërues, për dy workshope të realizuara me procedurë për blerje me vlera të vogla në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I, pika 1, me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2, dhe me Manualin e Procedurave Financiare dhe Administrative” pika 2.5.3.2.

Menjëherë

8. Në procedurën e kryer për blerje me vlera të vogla për “Programin kompjuterik Softwear”, u konstatua se me Urdhrin e prokurimit nr. 8 datë 20.02.2015, titullari i AK, urdhëron që të kryhet kontraktimi i drejtpërdrejtë me firmën, për të lidhur kontratën në shumën 147,900 lekë me TVSH, për periudhën nga data 23 shkurt-31 qershor 2015. Po me kërkesën e zj., përgjegjëse e financës dhe administratës është kërkuar rinovimi i kontratës, ku është kërkuar të ndryshohet afati i mbulimit të shërbimit nga data 23 shkurt- 31 qershor të bëhet në datat 5 shkurt-31 qershor 2015, si dhe të ndryshohet vlera e kontratës (për 18 ditë shtesë duke shkuar nga shuma 147,900 lekë, në shumën prej 208,800 lekë). pra duke e rritur vlerën e kontratës në shumën 60,900 lekë me TVSh. Bazuar në kërkesën e sektorit të financës për ndryshimin e kushteve të kontratës, ka dalë urdhër prokurimi me nr. 9 datë 09.03.2015, i drejtorit ekzekutiv z., ku kërkohet rilidhja e kontratës jo më me vlerën 208,800 lekë por në vlerën 178,628 lekë me TVSh duke përfshirë dhe periudhën shtesë nga data 5 shkurt-31 qershor. Kjo shtesë në vlerë **prej 30,728 lekë me TVSh, përbën dëm ekonomik**, veprime në kundërshtim me Manualin e Procedurave për Prokurimin pika III, “Procedurat e prokurimit” dhe pika IV “Përshkrimi i procedurave të prokurimit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 43-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MADA të marri masat për arkëtimin e vlerës 30,728 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga z. me detyrë drejtor ekzekutiv i MADA dhe zj., përgjegjëse e departamentit të financës, për shkelje në procedurën me vlera të vogla për blerje e programit software, e cila është kryer në kundërshtim me Manualin e Procedurave për Prokurimin pika III, “Procedurat e prokurimit” dhe pika IV “Përshkrimi i procedurave të prokurimit”.

Menjëherë

9. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale Mabë-Dragushë, Komuna Dajç, Lezhë”, nënshkruar me datë 25.04.2013, ndërmjet MADA-ës dhe operatorit ekonomik, me vlerë të punimeve 29,714,943 lekë me TVSH, u konstatuan diferenca çmimesh më të larta në krahasim me çmimet e ofertuara në procesin e tenderimit me **vlerë 2,845,795 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori

(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 2,845,795 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori, përfituar padrejtësisht për diferenca çmimesh në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale Mabë-Dragushë, Komuna Dajç, Lezhë”.

Menjëherë

10. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i kanalit ujitës Komuna Surroj, Kukës”, nënshkruar me datë 25.04.2013, ndërmjet MADA-ës dhe bashkimit të operatorëve ekonomikdhe....., me vlerë të punimeve 36,790,684 lekë me TVSH, u konstatuan diferenca çmimesh më të larta në krahasim me çmimet e ofertuara në procesin e tenderimit me **vlerë 5,311,575.6 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe

(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 5,311,575.6 lekë me TVSH, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori dhe, përfituar padrejtësisht për diferenca çmimesh në objektin “Rehabilitimi i kanalit ujitës Komuna Surroj, Kukës”.

Menjëherë

10. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i kanalit ujitës Klos Katundi Cërrojë, bashkia Klos”, nënshkruar me datë 30.04.2013, ndërmjet MADA-ës dhe operatorit ekonomik, me vlerë të punimeve 9,836,005 Lekë me TVSH, u konstatuan diferenca çmimesh më të larta në krahasim me çmimet e ofertuara në procesin e tenderimit **me vlerë 154,554.98 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori

(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 154,554.98 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori, për diferenca çmimesh në objektin “Rehabilitimi i kanalit ujitës Klos Katundi Cërrojë, bashkia Klos”.

Menjëherë

11. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Guri i Zi-Juban, Komuna Guri i Zi, Shkodër”, nënshkruar me datë 26.04.2013, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit të zonave Malore (MADA) dhe bashkimit të operatorëve ekonomik, me vlerë të punimeve 25,150,458 Lekë me TVSH, u konstatuan diferenca në volume më të larta në krahasim se volumet e ofertuara në procesin e tenderimit **me vlerë 634,152 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori
(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 634,152 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori, për diferenca punimesh të pakryera në objektin “Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Guri i Zi-Juban, Komuna Guri i Zi, Shkodër”.

Menjëherë

12. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i kanalit ujitës Guri i Bardhë” Komuna Xibër, Mat, nënshkruar me datë 13.06.2013, ndërmjet MADA-ës dhe bashkimit të operatorëve ekonomik dhe, me vlerë të punimeve 12,048,140 Lekë me TVSH, u konstatuan parregullsi në miratime punimesh **me vlerë 2,935,208 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe Gjithashtu ka pasur dhe vonesa punimesh dhe nga MADA nuk janë llogaritur dhe nuk janë mbajtur penalitete për këto vonesa **në shumën 2,408,938 lekë, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe
(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 5,344,146 lekë me TVSH, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori dhe, për punime të pamiratuara nga AK dhe për vonesa të krijuara në objektin “Rehabilitimi i kanalit ujitës Guri i Bardhë” Komuna Xibër, Mat”.

Menjëherë

13. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i Kanalit Ujitës në fshatin Dardhë”, Komuna Blerim, Pukë”, nënshkruar me datë 20.09.2011, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit të zonave malore dhe operatorit ekonomik, me vlerë të punimeve 23,760,689 Lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh të pakryera **me vlerë 1,649,760 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori
(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 1,649,760 lekë me TVSH, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori, për punime të pakryera në objektin “Rehabilitimi i Kanalit Ujitës në fshatin Dardhë”, Komuna Blerim, Pukë”.

Menjëherë

14. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale Cahan-Mujaj”, Bashkia Krume, Has”, nënshkruar me datë 20.10.2011, ndërmjet Agjencisë së zhvillimit të zonave malore dhe operatorit ekonomik, me vlerë të punimeve 13,372,720 Lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh të pakryera **me vlerë 1,638,939.6 lekë, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori
(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 1,638,939.6 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori, për punime të pakryera në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale Cahan-Mujaj”, Bashkia Krume, Has”.

Menjëherë

15. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale dhe kanalit Ujitës Porave, Komuna Fierzë, Pukë”, nënshkruar me datë 29.07.2013, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe operatorit ekonomik, me vlerë të punimeve 37,773,447 lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh të pakryera **me vlerë 294,436 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori
(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 294,436 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori, për punime të pakryera në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale dhe kanalit Ujitës Poravë, Komuna Fierzë, Pukë”.

Menjëherë

16. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale Mali i Lezajve, Komuna Gurre, Mat”, nënshkruar me datë 17.05.2013, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe operatorit ekonomik, me vlerë të punimeve 24,456,704 Lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh të pakryera **me vlerë 66,240 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori
(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 66,240 lekë, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori, për punime të pakryera në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale Mali i Lezajve, Komuna Gurrë, Mat”.

Menjëherë

17. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës në objektin “Rehabilitimi i rruges rurale Cërrujë-Kukatinë-Plezhë, Bashkia Klos”, nënshkruar me datë 28.10.2011, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore dhe bashkimit të operatorëve ekonomik dhe, me vlerë të punimeve 42,526,822 lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh të pakryera **me vlerë 999,900 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik** e përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe
(Trajtuar më hollësisht në faqen 78-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor të marri masat për arkëtimin e vlerës 999,900 lekë me TVSH, dëm ekonomik i shkaktuar nga kontraktori dhe, për punime të pakryera në objektin “Rehabilitimi i rrugës rurale Cërruje-Kukatine-Plezhë, Bashkia Klos”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin nr. 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kontratën kolektive të punës, i kërkojmë Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

1. “Largim nga puna”

a. Për z., me detyrë drejtor ekzekutiv i MADA-ës, për arsye se:

- Nuk ka mirë menaxhuar zbatimin dhe financimin e projektit, i cili pa pasur nivele shumë të ulëta të disbursimeve në vitet e para të zbatimit të tij, duke sjellë si pasojë dhe shtyrjen e afatit të disbursimeve dhe vonesa në përfundimin e projektit dhe objektivave të caktuara sipas marrëveshjeve të financimit.
- Nuk ka likuiduar detyrimet për 5 kontraktuesit, përkatësisht, në shumën 1,074,063 lekë, në shumën 1,770,733 lekë, në shumën 6,769,467 lekë, në shumën 4,592,370 lekë, dhe në shumën 497,628 lekë, duke sjellë pasojë për pagesa të penaliteteve për vonesat referuar detyrimeve kontraktuale. Nuk ka bashkëpunuar me kryetarët e komunave respektive, për të marrë në dorëzim punimet e kryera nga komunat përfituese të investimit, në kundërshtim me kontratat e nënshkruara, me qëllim likuidimin e detyrimeve brenda afatit të parashikuar.
- Ka lejuar të kryhen pagesa duke tejkaluar fondet e parashikuara, për kategorinë 4, “Trajnime dhe seminare”, përkatësisht në shumën 61,825 SDR, ose me një tejkalim në masën 126.65% të fondeve të parashikuara në marrëveshjen e financimit të kredisë nga IFAD .
- Ka lejuar të kryhen pagesa duke tejkaluar fondet e parashikuara në marrëveshjen e financimit të kredisë nga IFAD, në kategorinë “Trajnime profesionale”, përkatësisht nënkategoria e V.a, me një tejkalim për 107,897 SDR, ose në masën 183.27%, ndërsa nënkategoria V.b, pas rialokimit të fondeve janë tejkaluar fondet për shumën 206,897 SDR, ose në masën 115.03%.
- Ka lejuar të bëhen ndryshime të fondeve të kredisë brenda kategorive, në kundërshtim me marrëveshjen e financimit të kredisë dhe nenin 2.3.1 “Procedurat e Buxhetit” të Manuali i Financës dhe Administratës, ku përcaktohet se “..Kategoritë e shpenzimeve dhe natyra e aktiviteteve për çdo burim financimi të specifikuar në buxhetin e AZHZM, përcaktohen në Marrëveshjet e Kredisë/Grantit, të nënshkruara midis QSH dhe donatorit respektivë. Ndryshimet në kategori, natyrën e aktiviteteve dhe ndonjë rishpërndarje midis kategorive dhe natyrës së aktiviteteve, duhet të nënshtrohet miratimit nga Donatori si dhe nga Qeveria Shqiptare”.
- Ka bërë pagesa për firmën, në datë 23.10.2009, në shumën 330,010 lekë për blerje kancelarie për projektin, për të cilën nuk ka lidhur kontratë me firmën dhe nuk ka leshur një autorizim për blerje, me pasojë dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me Manuali i Procedurave financiare dhe administrative, Kapitulli 2, pika 2.5.3.8, ku përcaktohet se “...Pagesa për kancelari dhe materiale pastrimi do të bëhet në bazë të dokumentave të miratuara (kontrata, çeku, fatura e shitjes etj.) dhe urdhri që autorizon blerjen, i cili aprovohet nga Drejtori Ekzekutiv (DE), me propozim të Drejtorisë së Financës dhe Administratës (DFA). Pagesa duhet të kryhet pasi materialet të jenë bërë hyrje në magazinën e ADP nga personi i ngarkuar për këtë punë”.
- Në vitin 2014, ka lidhur kontrata pune individuale me afate të shkurtra për 6 persona, për të cilën nuk ka kryer procedurat për të marrë miratimin (no objection) për çdo person që do të rekrutohet nga MADA me kontratë individuale pune. Për pasojë IFAD nuk ka lëvruar fondin prej 20% të pagesës nga kontributi i saj, të parashikuar në marrëveshjen e huas, vlerë e cila është financuar me fondet e buxhetit të GOA.
- Nuk ka procesverbal për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, në tenderin e kryer me objekt “Blerje materiale pastrimi”, veprim në kundërshtim me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.2 “Blerje mallrash” ku citohet se “..duhet të gjendet bashkangjitur dokumentacioneve procesverbali i marrjes në dorëzim hartuar nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhrin e drejtorit ekzekutiv”, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I pika 1, ku citohet se “Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standard dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6

“Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2, dhe në kundërshtim me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.2.

- Në procedurën e kryer për tenderin me objekt “Blerje kancelarish”, mungojnë propozimet për financim e cili i drejtohet drejtorit ekzekutiv dhe një raport i shkurtër në lidhje me përfundimin e kontratës, veprim në kundërshtim me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.2. Gjithashtu nuk gjendet bashkëlidhur këtyre dokumentacioneve procesverbali për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, veprime në kundërshtim me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.8 “Pagesa për kancelari”, me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu i pika 1, dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2.

-Gjatë zbatimit të kontratës “Rehabilitimi i kanalit ujitës Guri i Bardhë” Komuna Xibër, Mat”, ka lejuar zgjatjen e afateve të punimeve në kundërshtim me kontratës e nënshkruar, si dhe ka miratuar urdhrin për ndryshime pas kolaudimit të veprës me zëra punime të mbivendosura, veprime në kundërshtim me kushtet e kontratës, me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.1 datë 16.06.2011 dhe me legjislacionin nr. 8402, datë 10.09.1998 për "Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

- Ka bërë rinovimin e kontratës me objekt “Programi software”, duke ndryshuar afatin e mbulimit të shërbimit dhe vlerën e kontratës, pra me një shtesë në vlerë prej 30,728 lekë me TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Ky veprim bie në kundërshtim me Manualin e procedurave për prokurimin pika III “Procedurat e prokurimit” dhe pika IV “Përshkrimi i procedurave të prokurimit”. *Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16, datë 22.07.2015 dhe në aktverifikimet nr.1,2,3,4 datë 22.07.2015.*

b. Për zj....., përgjegjëse e Departamentit të Financës dhe Administratës, për arsye se:

- Nuk ka likuiduar detyrimet për 5 kontraktuesit, përkatësisht, në shumën 1,074,063 lekë, në shumën 1,770,733 lekë, në shumën 6,769,467 lekë, në shumën 4,592,370 lekë, dhe në shumën 497,628 lekë, duke sjellë pasoja për pagesa të penaliteteve për vonesat referuar detyrimeve kontraktuale. Nuk ka bashkëpunuar me kryetarët e komunave respektive, për të marrë në dorëzim punimet e kryera nga komunat përfutuese të investimit, në kundërshtim me kontratat e nënshkruara, me qëllim likuidimin e detyrimeve brënda afatit të parashikuar.

- Ka lejuar të kryhen pagesa duke tejkaluar fondet e parashikuara, për kategorinë 4, “Trajnime dhe seminare”, përkatësisht në shumën 61,825 SDR, ose me një tejkalim në masën 126.65% të fondeve të parashikuara në marrëveshjen e financimit të kredisë nga IFAD .

- Ka lejuar të kryhen pagesa duke tejkaluar fondet e parashikuara në marrëveshjen e financimit të kredisë nga IFAD, në kategorinë “Trajnime profesionale”, përkatësisht nënkategoria e V.a, me një tejkalim për 107,897 SDR, ose në masën 183.27%, ndërsa nënkategoria V.b, pas rialokimit të fondeve janë tejkaluar fondet për shumën 206,897 SDR, ose në masën 115.03%.

- Ka lejuar të bëhen ndryshime në financimin e fondeve të kredisë brenda kategorive, në kundërshtim me marrëveshjen e financimit të kredisë dhe nenin 2.3.1 “Procedurat e Buxhetit” të Manuali i Financës dhe Administratës, ku përcaktohet se “..Kategoritë e shpenzimeve dhe natyra e aktiviteteve për çdo burim financimi të specifikuar në buxhetin e AZHZM, përcaktohen në Marrëveshjet e Kredisë/Grantit, të nënshkruara midis Qeverisë Shqiptare dhe donatorit respektivë. Ndryshimet në kategori, natyrën e aktiviteteve dhe ndonjë rishpërndarje midis

kategorive dhe natyrës së aktiviteteve, duhet ti nënshtrohet miratimit nga Donatori si dhe nga Qeveria Shqiptare”.

-Ka bërë pagesa për firmën, në datë 23.10.2009, në shumën 330,010 lekë për blerje kancelarie për projektin, për të cilën nuk ka lidhur kontratë me firmën dhe nuk ka lëshuar një autorizim për blerje, me pasojë dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me Manuali i Procedurave financiare dhe administrative, Kapitulli 2, pika 2.5.3.8, ku përcaktohet se “...Pagesa për kancelari dhe materiale pastrimi do të bëhet në bazë të dokumentave të miratuara (kontrata, ceku, fatura e shitjes etj.) dhe urdhëri që autorizon blerjen, i cili aprovohet nga Drejtori Ekzekutiv (DE), me propozim të Drejtorisë së Financës dhe Administratës (DFA). Pagesa duhet të kryhet pasi materialet të jenë bërë hyrje në magazinën e MADA nga personi i ngarkuar për këtë punë”.

- Ka kryer pagesat për shoqërinë e transportit, në shumën 70,000 lekë, me datë banke 17.11.2009, për shpenzime transporti në lidhje me aktivitetin e zhvilluar për “Pastorizimi dhe trashëgimia kulturore”, pagesa është bërë bazuar vetëm në një faturë të thjeshtë tatimore të lëshuar nga kjo shoqëri transporti, duke sjellë si pasojë dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me Kreun 2, pika 2.5.3.1, Manuali i Procedurave financiare dhe administrative (MPFA), dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Ka kryer pagesa në datë 2.12.2009, në shumën 200,000 lekë, për konsulentin, për asistencë teknike në promovimin e bizneseve në kuadrin e Panairit kombëtar, kjo pagesë është bërë në kundërshtim me pikën 2.5.3.1, të MPFA, pasi në faturën e paraqitur nga konsulenti janë të justifikuara shpenzimet vetëm për tarifat e konsulentit, ndërsa “Shpenzimet për materiale” (dosje) në shumën 30,000 lekë nuk ka fletëhyrjen në magazinë, “Shpenzimet për komunikimin” në shumën 30,000 lekë nuk ka dokumentacion justifikues se çfarë përfaqësojnë kjo vlerë, dhe “Shpenzime të tjera për transport” për konsulentin në shumën 20,000 lekë nuk ka dokumentacion shoqërues për llojin dhe mjetin e transportit dhe se sa kilometra janë sipas destinacionit. Pagesa pa dokumentacion justifikues në shumën 80,000 lekë për konsulentin, ka sjellë si pasojë dëm ekonomik për arsye se është bërë në kundërshtim me MPFA , Kapitulli 1, pika 2.5.3.1, dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Ka nxjerrë urdhër pagesën, për “Shpenzime blerje dosje, printime” nga, në shumën 22,500 lekë, datë 23.12.2009, dhe pagesa është bërë pa dokumentacion justifikues por vetëm me një faturë të thjeshtë tatimore. Mungojnë dokumentat që të vërtetojë qëllimin se përse janë blerë. Ky veprim ka sjellë si pasojë dëm ekonomik, për arsye se është bërë në kundërshtim me MPFA, Kapitulli 1, pika 2.5.3.1, dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Ka kryer pagesën në shumën 576 euro, datë bankë 26.02.2010, për udhëtim jashtë vëndit, për pjesmarrje në seminarin për politikën Rajonale, në Bolonjë të Italisë, pagesa për biletat e avionit për dy persona është bërë nga financa pa autorizimin e Drejtorit ekzekutiv i cili miraton emrat e personave që do marrin pjesë në seminar si dhe kohën e qëndrimit dhe qëllimin përse do shkojnë në këtë udhëtim. Ky veprim bie ndesh me MPFA, kapitulli 2, pika 2.5.3.6 “Pagesat për udhëtime për punonjësit”.

- Ka kryer pagesat për materialet promovuese të blera për panairin e kryer në qytetin e Shkodrës “Artizani dhe gruaja shkodrane, 22 maj shkodër” për postera dhe banera, të cilta nuk janë bërë hyrje në magazinë, nga z..... dhe z....., si persona përgjegjës staf i MADA të angazhuar për kryerjen e aktivitetit, të cilët nuk kanë zbatuar procedurat për të bërë hyrje materialet që janë blera për këtë aktivitet, në shumën 134,790 lekë, e cila përbën dëm ekonomik në të ardhurat e projektit, për arsye se pagesa është bërë në kundërshtim me MPFA, kapitulli 2,

pika 2.5.3.1, dhe me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Nuk gjendet procesverbali për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, në tenderin e kryer me objekt “Blerje materiale pastrimi”, veprime në kundërshtim me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.2 “Blerje mallrash” ku citohet se duhet të gjendet bashkangjitur dokumentacioneve procesverbali i marrjes në dorëzim hartuar nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhrin e drejtorit ekzekutiv, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I pika 1, me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2, dhe me Manualin e financës dhe administratës pika 2.5.3.2.

- Në procedurën e kryer për tenderin me objekt “Blerje kancelarish”, mungojnë propozimet për financim e cili i drejtohet drejtorit ekzekutiv dhe një raport i shkurtër në lidhje me përfundimin e kontratës, veprim në kundërshtim me Manualin e financës dhe administratës pika 2.5.3.2. Gjithashtu nuk gjendet bashkëlidhur këtyre dokumentacioneve procesverbali për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, veprim ky që bie në kundërshtim me manualin e financës dhe administratës pika 2.5.3.8 “Pagesa për kancelari” dhe ky veprim bie në kundërshtim dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin E Aktiveve Në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu i pika 1. ku citohet se “Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave standard dhe gjurmën e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi te aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2.

-Gjatë zbatimit të kontratës “Rehabilitimi i kanalit ujitës Guri i Bardhë” Komuna Xibër, Mat”, ka lejuar të bëhet pagesa përtej afateve të punimeve në kundërshtim me kushtet e kontratës, dhe udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 16.06.2011 dhe legjislacionin nr. 8402, datë 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

- Ka bërë rinovimin e kontratës me objekt “Programi software”, duke ndryshuar afatin e mbulimit të shërbimit dhe vlerën e kontratës, me një shtesë në vlerë prej 30,728 lekë me TVSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Ky veprim bie në kundërshtim me Manualin e procedurave për prokurimin pika III Procedurat e prokurimit dhe pika IV Përshkrimi i procedurave të prokurimit.

- Mungojnë në dosjen e tenderit për “Blerje Makinash”, propozimi për financim i cili i drejtohet drejtorit ekzekutiv, si dhe një raport i shkurtër në lidhje me përfundimin e kontratës dhe fatura tatimore, veprim në kundërshtim me Manualin e financës dhe administratës pika 2.5.3.2. veprim në kundërshtim me Manualin e financës dhe administratës pika 2.5.3.2 ku citohet se Blerja e automjeteve mallrave dhe pajisjeve të zyrës dhe informatikës duhet të kenë të bashkangjitur në fillim pika 1 propozimin financiar i cili i drejtohet drejtorit ekzekutiv dhe pasi të miratohet kalon një kopjo juristit për të vazhduar më tej procedurën juridike dhe pika 7, ku citohet se duhet të hartohet një raport i shkurtër në lidhje me përfundimin e blerjes së kontratës.

- Në procedurën e kryer për tenderin “Blerje Kancelarie”, mungon procesverbali për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, veprim në kundërshtim me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.8 “Pagesa për kancelari”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I pika 1, me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 Evidenca mbështetëse pika 1 dhe 2, dhe me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.2

- Ka kryer likuidimin për firmën, në shumën 267,360 lekë, bazuar vetëm në një faturë tatimore me nr. 20470310 më datë 26.03.2015, e cila është prerë një vit më mbrapa se urdhi i pagesës i datës 20.04.2014, duke sjellë si pasojë një dëm ekonomik për arsye se është

bërë pa dokumentacion shoqërues, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu I pika 1, me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Neni 6 Evidenca mbështetëse pika 1 dhe 2, dhe me Manualin e Financës dhe Administratës pika 2.5.3.2.

-Në procedurën e kryer për blerje me vlerë të vogël me objekt “Materiale Pastrimi”, me vlerën 62,935 lekë, është likuiduar pagesa për firmën, nëpërmjet faturës nr.17007117 datë 06.03.2015 me vlerë 62,935 lekë, por nuk është firmosur kërkesa për materiale dhe nga personi që ka bërë kërkesën, si dhe nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të materialeve të blera.

Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16, datë 22.07.2015 dhe në aktverifikimet nr.1,2,3,4 datë 22.07.2015.

Shënim: Do rekomandonim masa disiplinore, për zj....., ish-drejtoresh ekzekutive e MADA-as, z....., ish-menaxheri i kontratave të punimeve civile, z....., ish-menaxheri i kontratave të punimeve civile, për antarët e Komisionit të prokurimeve dhe Vlerësimit të ofertave, zj....., z....., z....., zj....., zj....., zj..... dhe z., por meqenëse janë larguar nga detyra që kanë mbajtur për periudhën viti 2009-2014 në MADA, masa disiplinore konsiderohet e ezauruar.

Në vijim do të njoftohet Drejtoria e Administratës Publike për personin e lartpërmendur.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Luljeta Shtylla, Enida Mata, Aldo Kume dhe Gerti Bode, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj